LIGJ
Nr. 41/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN (KFW), PËR PROGRAMIN PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM DHE MIQËSOR ME KLIMËN NË SEKTORIN E MBETJEVE TË NGURTA

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin për menaxhim të qëndrueshëm dhe miqësor me klimën në sektorin e mbetjeve të ngurta, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 94, datë 3.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

M A R R Ë V E S H J E H U A J E

e datës 29.12.2022

ndërmjet

KfW, Frankfurt am Main
("KfW")

dhe

Republikës së Shqipërisë
të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
("Huamarrësi")

për shumën

50,000,000.00 EURO

- Programi për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta -

BMZ-No. 2018 68 199
Huaja Nr. 30565

P Ë R M B A J T J A

P Ë R M B A J T J A
P R E A M B U L Ë
1. Huaja
2. Disbursimi
3. Tarifat
4. Interesi
5. Shlyerja dhe parapagimi
6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
8. Paligjshmëria
9. Kostot dhe detyrimet publike
10. Detyrime të veçanta
11. Përfundimi i Marrëveshjes
12. Përfaqësimi dhe deklaratat
13. Publikimi dhe transferimi i Informacionit lidhur me Programin
14. Dispozita të përgjithshme
Shtojca 1 Skeduli i Disbursimit
Shtojca 2a Zotimet e Përputhshmërisë për Huamarrësin

PREAMBULË

Baza për këtë Marrëveshjeje Huaje ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit (**"Marrëveshja" ose "Marrëveshja e Huasë"**) është marrëveshja e datës 27 janar 2021 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (FC) ("**Marrëveshja Qeveritare**").

KfW-ja do të rifinancojë Huanë e dhënë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione interesi nga fondet e buxhetit me interes të ulët të siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për politika zhvillimi. Termat dhe kushtet e Huasë janë në përputhje me kërkesat e OECD-së, të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen e Asistencës Zyrtare të Zhvillimit (ODA).

Mbi këtë bazë dhe sipas kushtit që Republika Federale e Gjermanisë jep një garanci për Huanë, KfW-ja do të japë një Hua në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

Kjo Marrëveshje është pjesë e programit për Menaxhim të Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta ("**Programi**"). Zbatimi i Programit do të financohet me anë të një huaje që do të sigurohet sipas kësaj marrëveshjeje huaje ("**Marrëveshja e Huasë**"), një granti sipas një marrëveshjeje granti për një grant investimi ("**Marrëveshja e Grantit për Investimin**"), një granti sipas një marrëveshjeje granti të financuar nga SECO ("**Marrëveshja e Grantit SECO**") dhe një granti sipas një marrëveshjeje granti për masat shoqëruese ("**Marrëveshja e grantit për masat shoqëruese**"), të gjitha të së njëjtës ose rreth datës me këtë marrëveshje.

Huaja

1.1 *Shuma.* KfW-ja do t'i japë Përfituesit një Hua që nuk tejkalon shumën prej

50,000,000.00 Euro ("Huaja")

(me fjalë: pesëdhjetë milionë Euro).

1.2 *Qëllimi.* Huamarrësi do të përdorë Huanë vetëm për zbatimin e Programit. Në kuadër të këtij Programi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ("**MIE**"), nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (**'Njësia e Koordinimit të Programit' ose 'NJKP'**), do të veprojë si njësia e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin e përgjithshëm të projektit dhe zbatimin e Programit. NJKP-ja dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja duke nënshkruar një marrëveshje të veçantë ("**Marrëveshja e Veçantë**"), e cila gjithashtu nënshkruhet si e lexuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 *Taksat, tarifat dhe detyrimet doganore.* Taksat dhe tarifat e tjera publike që duhet të paguhen nga Huamarrësi, si dhe detyrimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Disbursimi

2.1 *Kërkesa për disbursim.* Sapo të gjitha kushtet, para disbursimit, në zbatim të Nenit 2.3 (*Kushtet para disbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje të përmbushen, KfW-ja do të disbursojë Huanë në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesën e Huamarrësit. Disbursimet do të kryhen në përputhje me Skedulin e Disbursimit që përfshihet në Shtojcën 1 (*Skeduli i Disbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuar në Shtojcën 1. Në masën që Huamarrësi, kërkon disbursim me shuma më të vogla brenda ndonjë periudhe të tillë, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në secilën prej periudhave vijuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime prej më pak se 200,000.00 EURO.

2.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve.* KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 shtator 2028.

2.3 *Kushtet para disbursimit.* KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje vetëm nëse janë plotësuar kushtet pararendëse të mëposhtme në një mënyrë të pranueshme për KfW-në në formë dhe përmbajtje:

a) Huamarrësi do të ketë provuar, siç e kërkon KfW-ja, me anë të paraqitjes së një opinioni ligjor dhe kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje), të të gjithë dokumenteve të cilave i referohet ky opinion ligjor, se Marrëveshja e Huasë është ligjërisht në fuqi dhe e zbatueshme dhe në mënyrë të veçantë se:

   i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas të drejtës kushtetuese dhe dispozitave të tjera ligjore të zbatueshme për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe

   ii) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha taksat mbi të ardhurat nga të ardhurat e interesit dhe të gjitha tarifat, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë, gjatë Huadhënies;

b) KfW-ja zotëron një dokument origjinal të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar me fuqi ligjërisht detyruese, dhe;

c) Nënshkrimet model të përmendura në Nenin 12.1 *(Përfaqësimi i Huamarrësit)* të kësaj Marrëveshjeje janë marrë nga KfW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në Nenin 7 *(Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë)* është në fuqi dhe efekt pa ndonjë kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar Tarifën e Menaxhimit të përcaktuar në Nenin 3.2 (Tarifa e Menaxhimit) të kësaj Marrëveshjeje;

f) nuk ka ndodhur asnjë arsye për përfundim, asnjë incident nuk ka ndodhur i cili do të bëhej shkak për përfundim me njoftim ose skadim ose konstatim ose përmbushje të një kushti (arsye e mundshme për përfundim); dhe

g) asnjë rrethanë e jashtëzakonshme nuk ka lindur që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

KfW-ja ka të drejtë, përpara çdo disbursimi nga Huaja, që të kërkojë dokumente dhe prova të mëtejshme që i çmon të nevojshme, sipas

diskrecionit të saj, për të vlerësuar përmbushjen e kushteve paraprake për disbursimin e specifikuar në këtë seksion.

2.4 *Detajet e procedurës së disbursimit.* NJKP-ja, dhe KfW-ja do të përcaktojnë (i) detajet e procedurës së disbursimit, duke nënshkruar Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet gjithashtu si e lexuar dhe e rënë dakord nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që vepron në emër të Huamarrësit, dhe, (ii) në mënyrë të veçantë, provat që duhet të jepen nga Huamarrësi, i cili vepron nëpërmjet NJKP-së, që dokumentojnë se shumat e kërkuara të Huasë po përdoren për qëllimin e pranuar.

2.5. *E drejta për të anuluar disbursimet.* Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas Nenit 10 (*Detyrimet e Veçanta*) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huasë me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së një **Tarife Mos-Shfrytëzimi** sipas dhe siç përcaktohet në Nenin 2.6 (*Tarifa e Mos-Shfrytëzimit*) të kësaj Marrëveshjeje

2.6. *Tarifa e Mos-Shfrytëzimit*. Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume Huaje, për të cilën është përcaktuar një përqindje interesi sipas Nenit 2.5 (*E drejta për anulimin e disbursimeve*) të kësaj Marrëveshjeje, ose nëse kjo shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet deri në afatin e caktuar në Nenin 2.2 (*Afati për kërkimin e disbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e saj, shumën e nevojshme për të kompensuar KfW-në për humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i mos-disbursimit të shumës së Huasë ("**Tarifa e Mos-Shfrytëzimit**"), përveç kur ky mos-disbursim përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e Tarifës së Mos-Shfrytëzimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Tarifa e Mos-Shfrytëzimit do të përcaktohet sikur asnjë subvencion interesi të mos ishte dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë për Programin.

3. Tarifat

3.1 *Tarifa e Angazhimit.* Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme ("**Tarifa e Angazhimit**") për shumat e padisbursuara të Huasë, siç përcaktohet më tej më poshtë.

Tarifa e Angazhimit duhet të paguhet për pagesën e prapambetur çdo gjashtë muaj, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë më 15 maj 2023, por jo më herët sesa në datën përkatëse pas ditës kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt sipas Nenit 14.10 (*Hyrja në fuqi dhe efekt*) të kësaj Marrëveshjeje.

Tarifa e Angazhimit do të ngarkohet nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huasë ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit definitiv të disbursimeve nga Huaja.

Tarifa e Angazhimit llogaritet si vijon:

i) Për periudhën që fillon 12 muaj pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Huaje nga KfW-ja, nëse zbatohet me efekt prapaveprues, deri në 24 muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Huaje nga KfW-ja, Tarifa e Angazhimit do të jetë 0,125% në vit (me fjalë: zero pikë njëqind e njëzet e pesë për qind në vit).

ii) Për periudhën vijuese që fillon 24 muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Huaje nga KfW-ja, Tarifa e Angazhimit do të jetë 0,25 % në vit (me fjalë: zero pikë njëzet e pesë për qind në vit).

3.2 *Tarifa e Menaxhimit.* Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 0.5% të shumës së Huasë të përcaktuar në Nenin 1.1 *(Shuma)* të kësaj Marrëveshjeje ("**Tarifa e Menaxhimit**").

Tarifa e Menaxhimit paguhet në datën më të hershme të dy datave të mëposhtme: (i) përpara disbursimit të parë ose (ii) pas kalimit të tre muajve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Huaje nga KfW-ja ose pas kalimit të një muaji nga hyrja në fuqi dhe efekt e kësaj Marrëveshjeje (cilado datë e mëvonshme e përcaktuar sipas pikës (ii)). Tarifa e Menaxhimit duhet të paguhet sapo kjo Marrëveshje Huaje të jetë nënshkruar, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht apo vetëm pjesërisht ose nuk është disbursuar.

4. Interesi.

4.1 *Interesi*. Huamarrësi do t'i paguajë interes KfW-së, si më poshtë:

Norma fikse e interesit e përcaktuar pas disbursimit të Huasë. Huamarrësi do të paguajë interes mbi Huanë sipas dispozitave të mëposhtme:

a) *Norma e interesit*. Huamarrësi do të paguajë interes për secilën shumë të Huasë të disbursuar në një normë **("Norma Fikse e Interesit")** të përcaktuar nga KfW-ja brenda dy **Ditësh Bankare** (siç përcaktohet në Nenin 14.1 *(Dita Bankare)*) të kësaj Marrëveshjeje para disbursimit të shumës përkatëse të Huasë dhe që do të përbëhet nga:

(i) Norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes Rojters "**ICAPEURO**" ose nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme ose nëse nuk është e aksesueshme, në faqen Bloomberg **"ICAE"** (ose në një faqe vijuese që zëvendëson faqet Rojters ose Bloomberg të përcaktuara më lart). Nëse të dyja faqet nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme ose janë të pazëvendësueshme, KfW-ja do të përcaktojë këtë normë mbi bazën e kostove të saj efektive të financimit në tregun e kapitalit në Euro për maturimet që i korrespondojnë periudhave përkatëse të interesit fiks, sa më afër që të jetë e mundur,

(ii) plus një marzh prej 0.55% (me fjalë zerro pikë pesëdhjetë e pesë për qind) në vit që merr parasysh fondet e grantit të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0% në vit, Norma Fikse e Interesit do të jetë 0% në vit.

Norma Fikse e Interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa të jetë marrë kësti i fundit i shlyerjes në pajtim me skedulin e shlyerjes të përcaktuar në Nenin 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje.

b) *Konsolidimi.* Nëse është kryer më shumë se një disbursim nga Huaja, KfW-ja do të konsolidojë normat e interesit të caktuara për secilën shumë Huaje në një normë interesi të vetëm pas secilit disbursim. Kjo normë e konsoliduar Interesi fiks do t'i korrespondojë mesatares së ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja

dhjetore e parë e hequr është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja e parë dhjetore e hequr është e barabartë ose më e madhe se 5, dhe do të jetë baza për llogaritjen e mëtejshme të interesit nga data e secilit disbursim deri në disbursimin e ardhshëm. Pas disbursimit të plotë të Huasë, norma mesatare e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me skedulin e shlyerjes të përcaktuar në Nenin 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje.

c) *Njoftimi i normës së interesit*. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit Normën Fikse të Interesit të caktuar sipas Nenit 4.1 a) (*Norma e Interesit*) të kësaj Marrëveshjeje, pa vonesë, pasi të jetë caktuar. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit normën e interesit të konsoliduar sipas Nenit 4.1 b) (*Konsolidimi*) të kësaj Marrëveshjeje në Datën e ardhshme të Pagesës (siç përcaktohet në Nenin 4.3 (*Datat e Pagesës*) të kësaj Marrëveshjeje.]

4.2 *Llogaritja e Interesit*. Interesi për një shumë Huaje të disbursuar do të ngarkohet që nga data (ekskluzivisht) në të cilën shuma përkatëse e Huasë disbursohet nga llogaria e Huasë e mbajtur me KfW-në për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) kur shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, siç specifikohet në Nenin 6.3 (*Numri i llogarisë, koha e kreditimit*) të kësaj Marrëveshjeje. Interesi do të llogaritet në përputhje me Nenin 6.1 (*Llogaritja*) të kësaj Marrëveshjeje.

4.3 *Datat e Pagesës*. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e specifikuara më poshtë (secila një "**Datë Pagese**"):

a) Përpara datës së pagesës të kështit të parë të shlyerjes, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më herët sesa në Datën e Pagesës pas datës kur kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt sipas Nenit 14.10 (*Hyrja në Fuqi dhe Efekt*) të kësaj Marrëveshjeje;

b) Në datën e pagesës së kështit të parë të shlyerjes sipas Nenit 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje së bashku me një kést të tillë;

c) Më pas në datat e pagesës së kësteve të shlyerjes sipas Nenit 5.1

(*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje.

5. Shlyerja dhe parapagimi

5.1 *Skeduli i shlyerjes.* Huamarrësi do të shlyejë Huanë si më poshtë:

	Data e pagesës	Kësti i shlyerjes	
1	15 maj 2028	2,380,952.38	EURO
2	15 nëntor 2028	2,380,952.38	EURO
3	15 maj 2029	2,380,952.38	EURO
4	15 nëntor 2029	2,380,952.38	EURO
5	15 maj 2030	2,380,952.38	EURO
6	15 nëntor 2030	2,380,952.38	EURO
7	15 maj 2031	2,380,952.38	EURO
8	15 nëntor 2031	2,380,952.38	EURO
9	15 maj 2032	2,380,952.38	EURO
10	15 nëntor 2032	2,380,952.38	EURO
11	15 maj 2033	2,380,952.38	EURO
12	15 nëntor 2033	2,380,952.38	EURO
13	15 maj 2034	2,380,952.38	EURO
14	15 nëntor 2034	2,380,952.38	EURO
15	15 maj 2035	2,380,952.38	EURO
16	15 nëntor 2035	2,380,952.38	EURO
17	15 maj 2036	2,380,952.38	EURO
18	15 nëntor2036	2,380,952.38	EURO
19	15 maj 2037	2,380,952.38	EURO
20	15 nëntor 2037	2,380,952.38	EURO
21	15 maj 2038	2,380,952.40	EURO

Ky Skedul i Shlyerjes mund të rregullohet herë pas here në përputhje me Nenin 5.5 *(Skeduli i rishikuar i Pagesës).*

5.2 *Shumat e padisbursuara të Huasë.* Shumat e padisbursuara të Huasë do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të shlyerjes së fundit që duhet të paguhet sipas skedulit të shlyerjes të përcaktuar në Nenin 5.1 *(Skeduli i Shlyerjes)* të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur KfW-ja, në diskrecionin e vet të plotë, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste individuale.

5.3 *Shlyerjet në rastin e disbursimit jo të plotë*. Nëse një kést shlyerjeje duhet të paguhet përpara se Huaja të disbursohet plotësisht, kjo nuk do të cenojë skedulin e shlyerjes sipas Nenit 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që kësti i shlyerjes për t'u paguar sipas skedulit të shlyerjes është më i ulët sesa shuma e Huasë e disbursuar dhe që nuk

është shlyer ende ("**Shuma e Huasë për t'u Paguar**"). Nëse kësti i shlyerjes që duhet të paguhet në përputhje me Nenin 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje tejkalon Shumën e Huasë për t'u Paguar, ky këst shlyerjeje do të reduktohet në nivelin e Shumës së Huasë për t'u Paguar dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë në kështet e shlyerjes që duhen paguar. Në llogaritjen e Shumës së Huasë për t'u paguar, KfW-ja rezervon të drejtën për të konsideruar disbursime nga Huaja, të cilat kryhen brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditësh para një Date Pagese për të përcaktuar Shumën e Huasë për t'u Paguar vetëm për Datën Vijuese të Pagesës.

5.4 *Parapagimi*. Sa më poshtë do të zbatohen për parapagimet:

a) E drejta për parapagim. Në bazë të paragrafëve të mëposhtëm 5.4 b) (*Njoftimi*) deri 5.4g) (*Kompensimi*) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e Huasë përpara datës së planifikuar të pagesës, nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje sipas Nenit 5.1 (*Skeduli i Shlyerjes*) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Njoftimi. Parapagimi i një shume Huaje sipas Nenit 5.4 a) (*E drejta për parapagim*) të kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet njoftimit të parapagimit nga Huamarrësi për KfW-në jo më vonë sesa në Ditën e pesëmbëdhjetë Bankare para datës së synuar për parapagim. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin që t'i paguajë KfW-së shumën e deklaruar në datën e caktuar.

c) Tarifa e Parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë fikse interesi Huaje, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesë, një shumë të tillë që është e nevojshme për të kompensuar humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i këtij parapagimi («Tarifa e Parapagimit»). KfW-ja do të përcaktojë shumën e Tarifës së Parapagimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Tarifa e parapagimit do të përcaktohet sikur asnjë subvencion interesi të mos ishte dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë për Programin.

d) Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i sigurojë Huamarrësit një tregues të shumës së Tarifës së Parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm të shlyerjes sipas Nenit 5.4 b) (*Njoftimi*) të kësaj Marrëveshjeje.

e) *Shumat e kërkueshme.* Së bashku me parapagimin sipas Nenit 5.4 a) (*E drejta e parapagimit*) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

(i) çdo Tarifë Parapagimi për t'u paguar si rezultat i parapagimit sipas Nenit 5.4 c) (*Tarifa e Parapagimit*) të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(ii) të gjithë interesin e shtuar mbi shumën e parapaguar të Huasë dhe pagesat e tjera ende të pakryera sipas kësaj Marrëveshjeje që janë shtuar deri në datën e parapagimit.

f) *Kompensimi.* Neni 5.2 (Shumat e padisbursuara të Huasë) të kësaj Marrëveshjeje do të zbaohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

5.5 *Skeduli i rishikuar i shlyerjes*. Në rast se zbatohet Neni 5.3 (*Shlyerjet në rast disbursimi jo të plotë*) ose Neni 5.4 (*Parapagimi*) të kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një skedul të rishikuar shlyerjeje, i cili do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë skedulin e shlyerjes, të vlefshëm deri në atë kohë.

6. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

6.1. *Llogaritja.* Interesi, Tarifa e Angazhimit, interesi i kamatëvonesës sipas Nenit 6.5 (*Interesi i Kamatëvonesës*) të kësaj Marrëveshjeje, pagesat e kompensimit me shumë të vetme/fikse për shumat e vonuara të pagesës sipas Nenit 6.6 (*Kompensimi me shumë të vetme/fikse*) të kësaj Marrëveshjeje, Tarifa e Mos-Shfrytëzimit dhe Tarifa e Parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti 360 ditor me muaj prej tridhjetë ditësh.]

6.2. *Data e pagesës*. Nëse një pagesë që do të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bie në një datë që nuk është Ditë Pune Bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë një pagesë të tillë në Ditën vijuese të Punës Bankare. Nëse Dita vijuese e Punës Bankare bie brenda muajit vijues

kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në Ditën e Fundit të Punës Bankare të muajit aktual kalendarik.

6.3. *Numri i llogarisë, koha e kreditimit.*

Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij për pagesë në lidhje me këtë Marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse i janë kredituar KfW-së në disponim të lirë të saj, pa asnjë zbritje në Euro dhe jo më vonë se në orën 10.00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, numri IBAN DE 09 5002 0400 3102 5608 01, duke caktuar datën e pagesës si një referencë shtesë ("Ref. VVVVMMDD").

6.4. *Kundërpretendimet/kundërpadítë e Huamarrësit.* Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë asnjë të drejtë për mbajtje ose kompensim ose të drejta të ngjashme kundrejt detyrimeve të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kur këto të drejta njihen me vendim deklarues ose nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

6.5. *Interesi i kamatëvonesës.* Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagimi sipas Nenit 5.4 (*Parapagimi*) të kësaj Marrëveshjeje nuk është në dispozicion të KfW-së kur duhet kryer pagesa, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të ngarkojë interesin e kamatëvonesës në normën 200 pikë bazë mbi përqindjen e interesit në vit, siç përcaktohet në Nenin 4.1 *(Interesi)* të kësaj Marrëveshjeje për periudhën që fillon në datën e pagesës dhe që përfundon në datën kur këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në Nenin 6.3 (*Numri i llogarisë, koha e kreditimit*) të kësaj Marrëveshjeje. Ky interes kamatëvonese duhet të paguhet menjëherë, me kërkesën e parë të KfW-së.

6.6. *Kompensimi me pagesë të vetme*. KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim me pagesë të vetme për shumat e vonuara të pagesës (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimeve të përmendura në Nenin 6.5 (*Interesi i Kamatëvonesës*) të kësaj Marrëveshjeje) nga data e pagesës deri në datën e pagesës në vlerën 200 pikë bazë në vit mbi Përqindjen Fikse të Interesit sipas Nenit 4.1 (*Interesi*) të kësaj Marrëveshjeje. Kompensimi me shumë të vetme/fikse duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë

të provojë se nuk ka ndodhur asnjë dëm ose se dëmet kanë qenë më të vogla sesa kompensimi me shumë të vetme.

6.7. *Kompensimi*. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesa kundrejt pagesave që duhet të kryhen sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të tjera të Huasë të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

6.8 *Llogaritjet e kryera nga KfW-ja*. Gabimet e dukshme të mungesave, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave që duhen paguar në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, përbëjnë provë *prima-facie* (*Anscheinsbeweis*).

7. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë pretendime pagese sipas kësaj Marrëveshjeje, të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë përpara disbursimit të parë.

8. Veprimet e kundërligjshme

Nëse, në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, bëhet e paligjshme për KfW-në që të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të saj, siç parashikohet nga kjo Marrëveshje Huaje ose për të financuar ose mirëmbajtur Huanë, me njoftimin e Huamarrësit nga KfW-ja

a) angazhimi i KfW-së do të anulohet menjëherë, dhe

b) Huamarrësi do të shlyejë Huanë plotësisht në datën e specifikuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar tek Huamarrësi (e cila duhet të jetë jo më herët sesa dita e fundit e ndonjë periudhe të zbatueshme pas datës së duhur të pagesës, të lejueshme me ligj).

Për shmangien e dyshimit, çdo anulim i kësaj Marrëveshjeje do t'i nënshtrohet Nenit 2.6 *(Tarifa e Mos-Shfrytëzimit)* dhe çdo shlyerje e Huasë sipas kësaj Marrëveshjeje përbën një parapagim dhe do t'i nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në Nenin 5.4 (c) *(Tarifa e Parapagimit)* dhe f) *(Shumat e kërkueshme).*

9. Kostot dhe detyrimet publike

9.1. *Asnjë zbritje ose mbajtje në burim*. Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje pa asnjë zbritje për taksat,

detyrimet e tjera publike ose kostot e tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera që të bëjë ndonjë zbritje të tillë ose të mbajë shuma mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten me shuma të tilla siç është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plotë shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje pas zbritjes së taksat dhe detyrimeve.

9.2. *Kostot*. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që lindin në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huasë, në mënyrë të veçantë kostot e dërgesave dhe transferimeve (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me mirëmbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje Huaje, si dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj.

9.3. *Taksat dhe tarifat e tjera*. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nëse KfW-ja i kërkon paradhënie këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të specifikuar në Nenin 6.3 (*Numri i Llogarisë, koha e kreditimit*) të kësaj Marrëveshjeje ose në llogari tjetër, siç specifikohet nga KfW-ja.

10. Detyrimet e veçanta

10.1. *Zbatimi i projektit dhe informacioni i veçantë.* Huamarrësi, në këtë drejtim i përfaqësuar nga NJKP-ja,

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Programin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me hartimin e Programit të pranuar ndërmjet NJKP-së, dhe KfW-së;

b) do t'ua caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) do të pajtohet në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të sigurojë financimin e plotë të Programit dhe do t'i vërë në dispozicion KfW-së me kërkesë të kësaj të fundit, dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga kjo Hua, dhe

e) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

f) do t'i mundësojë në çdo kohë KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ato libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin dhe funksionimin e Projektit, si dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

g) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe të dhënat që lidhen me Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

h) me nismën e vet, do t'i përcjellë menjëherë

(i) KfW-së çdo pyetje të marrë nga Huadhënësi nga OECD-ja ose anëtarët e tij sipas të ashtuquajturës "Marrëveshje për Transparencën e Kredive ODA të Bashkuara" pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve me KfW-në, dhe].

(ii) do të informojë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

10.2. *Detaje të Zbatimit të Programit.* NJKP-ja dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e lidhura me Nenin 10.1 (*Zbatimi i Programit dhe informacion i posaçëm*) të tij, duke nënshkruar Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të nënshkruhet si e lexuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që vepron në emër të Huamarrësit.

10.3. *Sipërmarrja e Përputhshmërisë*. Huamarrësi ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në Shtojcën 2 (*Zotimet e Përputhshmërisë së*).

10.4. *Transporti i furnizimeve*. Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare, të cilat janë të njohura për Huamarrësin, do të zbatohen për transportin e furnizimeve që duhet të financohen nga Huaja.

10.5. *Klasifikimi pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të përdoren minimalisht *pari passu* me të gjitha Borxhet e Jashtme të pasiguruara dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj që ky klasifikim të garantohet edhe për të gjitha detyrimet e ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë Marrëveshje, **"Borxh i Jashtëm**" nënkupton një detyrim të Huamarrësit, i cili:

(iii) rregullohet nga një sistem ligji i ndryshëm nga ligji i Huamarrësit; ose

(iv) I pagueshëm në një valutë të ndryshme nga valuta e vendit të Huamarrësit; ose

(v) I pagueshëm ndaj një personi të themeluar, me vendbanim, vendqëndrim ose me seli kryesore ose vend kryesor biznesi jashtë vendit të Huamarrësit.

11. Përfundimi i Marrëveshjes

11.1. *Arsyet e përfundimit*. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në Nenin 11.2 (*Pasojat juridike të shfaqjes së një shkaku të përfundimit*) të kësaj Marrëveshjeje, nëse krijohet një rrethanë që përbën një arsye të rëndësishme (*Wichtiger Grund*). Këto përfshijnë, veçanërisht, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk kryen detyrimet e pagesave ndaj KfW-së, kur është e kërkueshme;

b) shkelen detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, në Marrëveshjen e Grantit për Masat Shoqëruese, Marrëveshjen e Grantit për Investimin, Marrëveshjen e Grantit SECO, Marrëveshjen e Veçantë, si dhe në çdo marrëveshje tjetër shtesë ligjërisht të detyrueshme për këtë Marrëveshje ose marrëveshjet e lartpërmendura;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj nuk ka më efekt detyrues mbi Huamarrësin ose nuk mund të zbatohet më ndaj Huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe mirëmbajtjen e Huasë, provohet të jetë e rremë, çorientuese ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë kryerjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje;

f) Huamarrësi nuk mund të provojë që shumat e Huasë janë përdorur për qëllimin e caktuar ose

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, është i falimentuar ose fillon negociatat me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit;

11.2. *Pasojat ligjore të shfaqjes së një shkaku të përfundimit*. Nëse një nga rastet e përmendura në Nenin 11.1 (*Arsyet e përfundimit*) ka ndodhur, KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nëse ky rast nuk zgjidhet brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e Nenit 11.1a) të kësaj Marrëveshjeje) ose në të gjitha rastet e tjera të Nenit 11.1 (*Arsyet e përfundimit*) të kësaj Marrëveshjeje, brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga KfW-ja, periudhë e cila, gjithsesi, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të anulojë këtë Marrëveshje Huaje plotësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje do të pushojnë dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjithë ose një pjese të Shumës së Papaguar të Huasë, së bashku me interesin e shtuar dhe shumat e mbetura që i detyrohet kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nenet 6.5 (*Interesi i kamatëvonesës*) dhe 6.6 (*Kompensimi me pagesë të vetme*) të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis.*

11.3. *Kompensimi për dëmet*. Nëse kjo Marrëveshje Huaje përfundon plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë Tarifën e Mos - Shfrytëzimit, në përputhje me Nenin 2.6 (*Tarifa e Mos - Shfrytëzimit*) dhe/ose Pagesën e Parapagimit, në përputhje me Nenin 5.4 c) (*Tarifa e Parapagimit*).

12. Përfaqësimi dhe deklaratat

12.1. Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuara nga ai ose ajo, do të përfaqësojë Huamarrësin në të gjitha veprimet që kërkohen për zbatimin e Marrëveshjes së Huasë. Tagri i përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit i autorizuar në atë kohë.

12.2. *Adresat.* Deklaratat ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bëhen me shkrim. Çdo njoftim duhet të dërgohet origjinal. Çdo dhe të gjitha deklaratat ose njoftimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Germany (Gjermani)
Për Huamarrësin:	Republika e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë Blv. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3 1001 Tiranë, Shqipëri

13. Publikimi dhe transferimi i Informacionit lidhur me Programin

13.1. *Publikimi i informacionit të lidhur me programin nga KfW-ja*. Për të përmbushur parimet e pranuara ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (Pas Projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave para-kontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes (ve) të lidhur/a me Programin dhe në fazën pas-kontraktuale (në vijim e referuar si "**Periudha e Plotë**").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/en).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me Nenin 13.3 më poshtë (*Transferimi i informacionit në lidhje me programin tek*

palët e treta dhe publikimi nga ta) më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

13.2. *Transferimi i informacionit në lidhje me programin tek palët e treta*. KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar ransparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatin e Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO.

13.3. *Transferimi i informacionit në lidhje me programin tek palët e treta dhe publikimi prej tyre.* Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë seksione të lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës së Transparencës të Ndihmës Ndërkombëtare(http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html)

b) Tregu &Investimi Gjerman (GTAI). për qëllimet e informacionit për tregun (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html)

c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (http://www.oecd.org/)

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të garantuar transparencë dhe efikasitet (https://www.deval.org/en/);

e) Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO. (http://www.simap.ch).

13.4. *Transferimi i informacionit në lidhje me programin tek palët e treta (përfshirë publikimin nga ta)*. KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Programin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë tek palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshme të Huamarrësit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KFW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Huamarrësit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në Nenin 13.1, (*Publikimi i informacionit në lidhje me projektin nga KfW-ja*), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutore ose rregullatore ose për të ruajtur ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

14. Dispozita të përgjithshme

14.1. *Ditë Bankare*. Do të thotë çdo ditë (përveç të shtunës ose të dielës), në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main, Gjermani, janë të hapura për biznes të përgjithshëm; me kusht që për qëllime të përcaktimit të ndonjë date shlyerjeje dhe Datë Pagese në lidhje me një Hua të dhënë si më poshtë dhe për përcaktimin e ndonjë date për disbursimin ose pagesat e tjera sipas saj, kjo ditë duhet të jetë gjithashtu një Ditë TARGET.

DITË TARGET: Do të thotë çdo ditë në të cilën Sistemi Trans-Ekspres i Transferimit të Shlyerjes Bruto në kohë reale Trans-Europiane (TARGET) është i hapur për pagesa

14.2 *Vendi i kryerjes*. Vendi i kryerjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

14.3 *Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet ligjore.* Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Huaje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ka një boshllëk ligjor në cilindo nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të mbetura të saj. Palët e kësaj Marrëveshjeje Huaje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërisht të vlefshme, e cila i afrohet sa më shumë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të mbushin çdo boshllëk ligjor në dispozitat me një dispozitë të vlefshme ligjore e cila i afrohet sa më shumë frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

14.4 *Forma me shkrim.* Çdo shtesë dhe ndryshim në këtë Marrëveshje Huaje duhet të jetë me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kërkesa për formën me shkrim vetëm me kërkesë me shkrim. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim i cili përpara se të nënshkruhet, duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (Neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave

14.5 *Caktimi.* Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje.

14.6 *Ligji i zbatueshëm.* Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni gjerman.

14.7 *Afati i parashkrimit*. Të gjitha pretendimet e KfW-së në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje skadojnë pas pesë vitesh nga fundi i vitit kur është ngritur një kërkesë e tillë dhe kur KfW-ja është vënë në dijeni për rrethanat që përbëjnë një pretendim të tillë ose mund të ishte vënë në dijeni për to pa pakujdesi të rëndë.

14.8 *Heqja dorë nga imuniteti*. Nëse dhe në masën që Huamarrësi mund të kërkojë, aktualisht ose në të ardhmen, në ndonjë juridiksion, imunitet për vete ose pasuritë e tij dhe në atë masë që një juridiksion i jep imunitet Huamarrësit dhe pasurive të tij nga padia, ekzekutimi, konfiskimi ose procesi tjetër ligjor, Huamarrësi në mënyrë të pakthyeshme bie dakord të heqë dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

Me anë të përjashtimit, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me ekzekutimin e ndonjë vendimi arbitrar, në lidhje me:

(i) "ambientet e misionit" të tashme ose të ardhme, sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, "ambientet konsullore" të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

(ii) një pasuri e paluajtshme që përfshihet në objektin e Nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22/02/2001 "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore";

(iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas të drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj;

(iv) Çdo fond ose aset i planifikuar për qëllim publik në përputhje me parashikimet e detyrueshme të aplikueshme të parashikuara të ligjit ndërkombëtar dhe ligjit të huaj.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore

a) *Arbitrazhi.* Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të zgjidhen ekskluzivisht dhe në formë përfundimtare nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë kuadër, do të zbatohen sa më poshtë:

(i) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra, të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

(ii) Procedura e arbitrazhit do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedurës do të jetë gjuha angleze.

14.10 Hyrja në fuqi dhe efekt. Kjo Marrëveshje Huaje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën kur KfW-ja të ketë marrë një njoftim me shkrim nga Huamarrësi se procedurat e brendshme ligjore që duhet të përmbushen nga Huamarrësi, kanë përfunduar (data e marrjes së njoftimit nga KFW). KFW do të njoftojë Huamarrësin për marrjen e njoftimit.

Nëse Marrëveshja e Huasë nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje, ose në ndonjë afat tjetër siç mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja e Huasë dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Huamarrësit.

Hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.
Frankfurt am Main, 29 Dhjetor 2022

KfW

Emri: Arne Gooss
Pozicioni: Shef i divizionit të Infrastrukturës Komunale të Evropës Juglindore dhe Turqisë

Emri: Britt Horschke

Pozicioni: Drejtor Vendi i KfW

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Emri: Delina Ibrahimi

Pozicioni: Minister i Financave dhe Ekonomise

Shtojca 1

Skeudli i disbursimit

Skeduli i Disbursimit në mënyrën më të shpejtë të mundshme

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi ("**Data e Hyrjes në Fuqi e Mbarimit të Periudhës**", në përputhje me listën e mëposhtme) Huamarrësi mund të kërkojë disbursime vetëm deri në një nivel që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të specifikuara në tabelën e mëposhtme.

Periudha	**Data e Hyrjes në Fuqi e Fillimit të Periudhës (përfshirë)**	**Data e Hyrjes në Fuqi e Mbarimit të Periudhës (me përjashtim të)**	**Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative)** (të gjitha shifrat në Euro)
1	31.12.2022	01.01.2023	1.000.000,00
2	01.01.2023	01.07.2023	2.000.000,00
3	01.07.2023	01.01.2024	5.000.000,00
4	01.01.2024	01.07.2024	8.000.000,00
5	01.07.2024	01.01.2025	8.000.000,00
6	01.01.2025	01.07.2025	8.000.000,00
7	01.07.2025	01.01.2026	8.000.000,00
8	01.01.2026	01.07.2026	5,000,000.00
9	01.07.2026	01.01.2027	2,500,000.00
10	01.01.2027	01.01.2028	2,500,000.00

Shtojca2

Zotimet e Përputhshmërisë për Huamarrësin

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi;

Praktikë e Fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Praktikë Mashtruese: nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

Praktikë Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, Praktike të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit, ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese ose Praktike të Fshehtë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese, ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje) që (i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme dhe që (ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

Sanksione: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

Organ Sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë Organ Sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Huamarrësi, duke vepruar përmes NJKP-së

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me "njohjen e klientit" apo informacione të ngjashme për Huamarrësin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Huamarrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Huamarrësin që është e nevojshme për këtë qëllim;

